

POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËS E QENDRËS PËR ARSIM E KOSOVËS



Kjo politikë është hartuar në modelin e politikës së ofruar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF dhe Standardet Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Mars 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE.....	3
1.1. Qëllimi i politikës	4
1.2. Parimet dhe vlerat kryesore të KEC për mbrojtjen e fëmijëve	4
1.3. Përkufizime.....	5
1.4. Çfarë është abuzimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve	6
1.5. Nevoja për një politikë për mbrojtjen e fëmijëve.....	6
2. PARANDALIMI.....	8
2.1. Ndërgjegjësimi për Politikën për mbrojtjen e Fëmijëve.....	8
2.2. Vlerësimet e rrezikut dhe dizajni i programeve të sigurta	8
3. MASAT E SIGURISË.....	9
3.1. Procesi i rekrutimit të sigurt.....	9
3.2. Trajnimi dhe Edukimi.....	9
3.3. Protokollet e sjelljes.....	10
3.4. Personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve.....	10
3.5. Kodi i sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve.....	11
4. REAGIMI DHE MBROJTJA.....	13
4.1. Strategjia e zbatimit: Procedurat e raportimit.....	13
4.2. Strategjia e zbatimit: Prodedura e brendshme për mbrojtjen e fëmijëve.....	14
5. MEDIA DHE KOMUNIKIMI.....	15
5.1. Parimet.....	15
5.2. Pëlqimi i informuar.....	16
5.3. Intervistimi i fëmijëve.....	17
5.4. Vizitat nga fotografët, ekipet filmike, gazetarët dhe të tjerët.....	17
6. LLOGARIDHËNIA.....	18
6.1. Monitorimi dhe Vlerësimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve	18
6.2. Deklaratë e angazhimit ndaj Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve.....	19
6.3. Referenca të karakterit.....	20
SHTOJCA.....	21
Shtojca 1: Identifikimi i Shenjave të Abuzimit.....	21
Shtojca 2: Formulari i Raportimit për Mbrojtjen e Fëmijëve.....	23
Shtojca 3: Formularët e Pëlqimit.....	27
Shtojca 4: Formulari i Pëlqimit për Media.....	30

1

Hyrje

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) është organizatë joqeveritare dhe jopërfituese e themeluar në vitin 2000 duke u përqendruar në ofrimin e programeve të trajnimit të mësimeve në shërbim. Trajnimet ende mbesin një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së KEC, por, në kohë, organizata ka zgjeruar fushën e punës në katër fusha kyçe: 1) Përmirësimi i cilësisë së arsimit; 2) Të drejtat e njeriut; 3) Rrjetëzimi dhe pjesëmarrja në politikbërje; 4) Hulumtimet në fushën e arsimit.

Vizioni i KEC është: Një sistem efikas dhe gjithëpërfshirës i arsimit që i kontribuon zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit, duke aftësuar qytetarët për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për pjesëmarrje aktive në jetën demokratike.

Misioni i KEC është: Avancimi i sistemit të arsimit, përmes ofrimit të shërbimeve dhe burimeve të cilësisë së lartë, si dhe përmes bashkëpunimit aktiv me të gjitha palët me interes në vend dhe jashtë tij.

Në programet dhe projektet tona, përveç të rriturve (kryesisht palëve arsimore), herë pas here punojmë edhe me fëmijë, qoftë drejtpërdrejt apo përmes partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë. Duke përqafuar plotësisht Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (UNHCR), ne besojmë thellësisht se mbrojtja e fëmijëve është thelbësore për të siguruar që fëmijët nën moshën 18 vjeç të kenë një mjedis të sigurt dhe mbështetës gjatë pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet tona. Fëmijët mund të fuqizohen plotësisht vetëm nëse mbrohen nga abuzimi, diskriminimi dhe dëmtimi i çdo lloji, qoftë fizik, seksual, emocional apo lënia pas dore.

1.1. Qëllimi i politikës

Qëllimi i kësaj Politike për Mbrojtjen e Fëmijës është të krijojë një mjedis të sigurt dhe miqësor, duke siguruar standardet më të larta të sjelljes dhe praktikës profesionale, për të garantuar që asnjë dëm nuk u ndodh fëmijëve në çdo situatë gjatë përfshirjes së tyre në programet dhe projektet e KEC. Për më tepër, Politika për Mbrojtjen e Fëmijës synon të rrisë vetëdijen dhe mirëkuptimin e përbashkët mbi abuzimin, si dhe të krijojë një sistem për parandalimin, reagimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga format e ndryshme të abuzimit. Si rrjedhojë, i gjithë stafi dhe bashkëpunëtorët e KEC janë të detyruar të respektojnë këtë politikë. Më konkretisht, kjo Politikë për Mbrojtjen e Fëmijës zbatohet për:

- Të gjithë stafin, menaxhmentin, anëtarët e bordit, praktikantët, dhe vullnetarët;
- Të gjithë ata që veprojnë në emër të institucionit/organizatës, si anëtarë, këshilltarë apo trajnerë;
- Të gjithë të rriturit që shoqërojnë fëmijët në ngjarje dhe aktivitete të organizuara nga institucioni/organizata;
- Të gjithë pjesëmarrësit në ngjarjet e institucionit/organizatës, përfshirë fëmijët, gazetarët, sponsorët, donatorët, politikëbërësit, partnerët, etj.

Të gjithë individët e përmendur më lart do të lexojnë Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës të KEC dhe do të nënshkruajnë një deklaratë përkushtimi për të respektuar parimet dhe procedurat e saj.

1.2. Parimet dhe vlerat kryesore të KEC për mbrojtjen e fëmijës

Siç përcaktohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës

KEC është e përkushtuar për të mbrojtur fëmijët, siç përcaktohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. KEC siguron që të gjithë fëmijët e përfshirë në programet dhe projektet e saja të kenë të drejtë për:

- Shëndet, siguri, mirëqenie, dhe që interesi i tyre më i mirë të jetë gjithmonë prioritet;
- Zhvillim që u mundëson atyre të arrijnë potencialin e tyre të plotë;
- Të vlerësohen, respektohen dhe kuptohen në kontekstin e kulturës, fesë dhe përkatësisë së tyre etnike;
- Të dëgjohen dhe mendimet e tyre të merren seriozisht, si dhe të inkurajohen dhe ndihmohen për të marrë pjesë në vendimet që i prekin ata, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës.

Mbrojtja e fëmijës si përgjegjësi e panegociueshme

Të gjithë punonjësit e KEC kanë përgjegjësi absolute për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi brenda organizatës. Kjo detyrë është thelbësore dhe e panegociueshme. Ne jemi të vetëdijshëm se pa ndjekur standardet dhe mekanizmat për mbrojtjen e fëmijës, organizata mund të bie në neglizhencë dhe, në fund, të dështojë në detyrën e saj kryesore për kujdesin ndaj fëmijëve.

Krijimi i një mjedisi të hapur

KEC beson në:

- Krijimin e një mjedisi ku çështjet e mbrojtjes së fëmijëve diskutohen hapur dhe kuptohen nga fëmijët dhe të rriturit ;
- Promovimin e linjave të hapura të komunikimit brenda dhe jashtë organizatës, brenda dhe midis institucioneve dhe organizatave, për të rritur ndërgjegjësimin dhe zbatimin e politikave dhe praktikave të mbrojtjes së fëmijëve;
- Krijimin e një sistemi për të trajtuar në mënyrë të hapur, të qëndrueshme dhe të drejtë pretendimet për abuzim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

Pjesëmarrja e fëmijëve si themel i demokracisë së qëndrueshme

KEC punon me dhe për fëmijët në kuadër të programeve dhe projekteve të saja, duke synuar një shoqëri që respekton të drejtat e fëmijëve. KEC promovon krijimin e hapësirave ku fëmijët ndihen të sigurt për të folur rreth abuzimit dhe fuqizon ata që të bëhen pjesëmarrës në mbrojtjen e tyre, pa diskriminim. KEC promovon fuqizimin e fëmijëve duke i njohur ata me të drejtat e tyre dhe duke krijuar një mjedis të sigurt në të cilin mund t'i ushtrojnë këto të drejta. KEC promovon dhe siguron pjesëmarrjen e fëmijëve bazuar në **parimet e mëposhtme**:

- Pjesëmarrja është transparente dhe informuese.
- Pjesëmarrja është vullnetare.
- Pjesëmarrja është e bazuar në respekt.
- Pjesëmarrja është e rëndësishme.
- Pjesëmarrja udhëhiqet nga fëmijët.
- Pjesëmarrja është gjithëpërfshirëse.
- Pjesëmarrja mbështetet përmes trajnimit.
- Pjesëmarrja është e sigurt.

1.3. Përkufizime

• Fëmijë:

Çdo person nën moshën 18 vjeç, sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (1989).

• Mbrojtja e Fëmijës:

Në kontekstin e këtij dokumenti, mbrojtja e fëmijës nënkupton detyrën e institucionit/organizatës për të siguruar që personeli dhe programet e saj nuk dëmtojnë fëmijët, nuk i ekspozojnë ata ndaj rrezikut ose abuzimit, dhe që çdo shqetësim që institucioni/organizata ka për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve do t'i raportohet autoriteteve gjegjëse.

• Kontakt i drejtpërdrejt me fëmijët:

Kontakti i drejtpërdrejtë me fëmijët nënkupton praninë fizike të fëmijës/fëmijëve në kontekstin e punës së institucionit ose organizatës, pavarësisht nëse kontakti është i njehershëm apo i rregullt, afatshkurtër apo afatgjatë. Kjo mund të përfshijë pjesëmarrjen në takime dhe konferenca ku fëmijët janë të pranishëm ose ku punohet drejtpërdrejt me fëmijët në mjediset e institucionit ose organizatës.

• Kontakt i tërthortë me fëmijët:

Kontakti i tërthortë me fëmijët përfshin qasjen në informata mbi fëmijët në kontekstin e punës së institucionit ose organizatës, si emrat, adresat, fotografitë dhe rastet e tyre sociale.

1.4. Çfarë është abuzimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, “abuzimi i fëmijëve” apo “keqtrajtimi” përfshin të gjitha format e abuzimit fizik, abuzimit psikologjik, abuzimit seksual dhe lënies pas dore, që çojnë në dëmtim aktual ose të mundshëm për shëndetin, mbijetesën, zhvillimin ose dinjitetin e fëmijës, brenda kontekstit të një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti.¹

Përkufizimi ynë i abuzimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve përfshin, por nuk kufizohet në:

- **Abuzimi fizik**² mund të përfshijë goditje, tundje, hedhje, djegie, mbytje ose shkaktim të qëllimshëm të ndonjë lëndimi fizik te fëmija. Dëmi fizik mund të shkaktohet gjithashtu kur një prind ose kujdestar shkakton qëllimisht sëmundje te një fëmijë nën përkujdesin e tyre.
- **Abuzimi psikologjik**³ përkufizohet si keqtrajtimi i vazhdueshëm psikologjik i një fëmije, i cili sjell efekte të rënda dhe të qëndrueshme në zhvillimin e tij psikologjik dhe emocional. Kjo mund të përfshijë ndikimin që fëmijët të ndihen të pavlerë, të padëshiruar, të papërshtatshëm, ose të vlerësuar vetëm në masën që plotësojnë nevojat e një personi tjetër. Abuzimi psikologjik mund të përfshijë veprime që i bëjnë fëmijët të ndihen të frikësuar ose në rrezik, ose që i shfrytëzojnë ata. Nivele të ndryshme të keqtrajtimit emocional mund të jenë pjesë e të gjitha formave të abuzimit, megjithëse mund të ndodhë edhe në mënyrë të izoluar.
- **Abuzimi seksual**⁴ përfshin nxitjen ose detyrimin e një fëmije për të marrë pjesë në aktivitete seksuale, pavarësisht nëse fëmija e kupton ose jo se çfarë po ndodhë. Aktivitetet mund të përfshijnë kontakt fizik, duke përfshirë veprime depërtuese (p.sh përdhunim) ose jodepërtuese. Abuzimi seksual mund të përfshijë edhe aktivitete pa kontakt, si përfshirja e fëmijëve në shikimin ose prodhimin e materialeve pornografike ose nxitjen e sjelljeve seksuale të papërshtatshme.
- **Lënia pas dore**⁵ përkufizohet si dështimi i përsëritur i kujdestarit për të përmbushur nevojat themelore fizike dhe/ose psikologjike të fëmijës, duke rrezikuar dëmtimin e rëndë të zhvillimit fizik ose kognitiv të tij.

Një fëmijë që është keqtrajtuar mund të përjetojë më shumë se një lloj abuzimi. Diskriminimi, ngacmimi dhe bullizmi gjithashtu konsiderohen sjellje abuzive dhe mund të dëmtojnë fëmijën fizikisht dhe emocionalisht.

1.5. Nevoja për një politikë për mbrojtjen e fëmijës

Fëmijët janë të mbrojtur: Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të të mbrohen nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit, bazuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Prandaj, është përgjegjësi e organizatës të sigurojë që të gjitha aktivitetet, politikat dhe programet e saj të jenë “të sigurta për fëmijët”. Kjo do të thotë që stafi nuk përbën rrezik për fëmijët dhe që programet, politikat dhe praktikët mund të dizajnohen dhe zhvillohen në mënyra që promovojnë mbrojtjen e fëmijës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për fëmijët që janë të cenueshëm ndaj abuzimit, shfrytëzimit dhe keqtrajtimit nga kujdestarët, punonjësit e organizatës dhe ata që kanë qasje në informatat e tyre personale.

¹ The WHO definition of Child Abuse as defined by the Report of the Consultation on Child Abuse Prevention WHO– 1999

² Source: Child protection fact sheet: The definitions and signs of child abuse. NSPCC, 2009

³ Source: Child protection fact sheet: The definitions and signs of child abuse. NSPCC, 2009

⁴ Source: Child protection fact sheet: The definitions and signs of child abuse. NSPCC, 2009

⁵ Source: Child protection fact sheet: The definitions and signs of child abuse. NSPCC, 2009.

POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Stafi dhe bashkëpunëtorët e KEC janë të mbrojtur: Duke zbatuar standardet e politikës për mbrojtjen e fëmijës, i gjithë stafi dhe bashkëpunëtorët do ta kenë të qartë se si pritët të sillen me fëmijët dhe çfarë të bëjnë nëse ka shqetësime për sigurinë e një fëmije. Kështu, zbatimi i standardeve të mbrojtjes së fëmijës i mbron ata nga akuzat e rreme që mund të vijnë nga fëmijët ose të rriturit.

KEC dhe reputacioni i saj janë të mbrojtur: Duke zbatuar këto standarde, KEC bën të qartë angazhimin e saj për të mbajtur fëmijët të sigurt. Kjo do të na ndihmojë të ecim drejt praktikave më të mira në fushën e mbrojtjes së fëmijës. Të tjerët do ta përceptojnë KEC si një organizatë të besueshme që respekton të gjitha standardet e mira të operimit.

2

Parandalimi

2.1. Ndërgjegjësimi për Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës

Për zbatimin efektiv të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës, ajo duhet të kuptohet drejt nga të gjithë ata për të cilët zbatohet politika. KEC do të sigurojë që i gjithë stafi, praktikantët, vullnetarët, konsulentët, etj., të jenë të informuar për këtë politikë dhe të veprojnë në përputhje me të gjitha dispozitat e saj. Politika për Mbrojtjen e Fëmijës do t'u dërgohet të gjithë të rriturve përgjegjës pasi të jenë bashkuar në KEC në programet dhe projektet e saj.

2.2. Vlerësimet e rrezikut dhe disejnimi i programeve të sigurta

KEC është e përkushtuar të disenjojë programe që janë të sigurta për fëmijët. Prandaj, vlerësimet e rrezikut kryhen gjatë disenjimit të projekteve dhe aktiviteteve tona, dhe strategjitë e sigurisë zhvillohet në përputhje me to. Strategjitë për zbutjen e rreziqeve do të zhvillohen gjithashtu, për të zvogëluar rreziqet për fëmijët, dhe do të jenë pjesë e të gjitha operacioneve dhe aktiviteteve që përfshijnë ose ndikojnë në fëmijët.

3

Masat e sigurisë

3.1. Procesi i rekrutimit të sigurt

Si kusht për të punuar me KEC, i gjithë stafi, menaxhmenti, anëtarët e bordit, praktikantët, vullnetarët dhe kushdo që vepron në emër të institucionit/organizatës, si anëtarët, konsulentët ose trajnerët, duhet t'i nënshtrohen:

1. Pranimit dhe angazhimit për Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodin e Sjelljes për punën me fëmijët, duke nënshkruar deklaratën e përkushtimit (shih shtojcën) për të respektuar parimet dhe procedurat e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës.
2. Verifikimit të identitetit të kandidatit, pasi shkelësit mund të japin informata të rreme, përfshirë identitetin e rremë, për të siguruar punësim.
3. Konfirmimit që personi nuk është nën hetim; ky duhet të kërkohet nga policia ose gjykata.
4. Emrave dhe kontakteve të dy personave referentë të cilët e kanë njohur kandidatin por jo më pak se dy vjet, duke përjashtuar personat me të cilët kanë lidhje familjare. Identiteti i referencave duhet të verifikohet.

3.2. Trajnimi dhe edukimi

Edukimi dhe trajnimi janë thelbësore për zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës

Kjo përfshin:

1. Në fillim të periudhës së punësimit (brenda 3 javëve nga marrja e pozitës), stafi, vullnetarët/praktikantët duhet t'i nënshtrohen trajnimit për Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës nga personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj politike.
2. Trajnimi për mbrojtjen e fëmijës duhet të ofrohet për gjithë stafin, vullnetarët dhe praktikantët, pa përjashtim.
3. Regjistrimet e sesioneve të trajnimit të mbajtura duhet të ruhen në dosjet e organizatës.

3.3. Protokollet e sjelljes

Çdo anëtar i stafit, punonjës, vullnetar, praktikant, anëtar i bordit, konsulent ose këshilltar do të informohet plotësisht për Kodin e Sjelljes së Institucionit/Organizatës.

3.4. Personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve

Organizata/institucioni duhet të caktojë një person brenda organizatës, si përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve. Ky person do të jetë përgjegjës për:

- Veprimin si pikë kryesore e kontaktit për shqetësimet lidhur me incidentet e mbrojtjes së fëmijëve dhe ngritjen e këtyre shqetësimeve te menaxhmenti/bordi;
- Promovimin e zbatimit të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës në të gjithë institucionin/organizatën;
- Monitorimin e zbatimit të politikës dhe raportimin për zbatimin e saj në takimet e ekipit, takimet e menaxhmentit, përmes raporteve të shkruara periodike, etj;
- Identifikimin dhe lehtësimin e mundësive për trajnime për mbrojtjen e fëmijëve;
- Mbajtjen e regjistrimeve të sakta të çdo incidenti;
- Shërbimin si burim mbështetjeje për stafin dhe bashkëpunëtorët e KEC për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.

Kompetencat minimale që duhet të shfaqen nga personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve janë:

- Njohuritë dhe përvoja në mbrojtjen e fëmijëve;
- Respekti dhe autoriteti brenda organizatës për të siguruar që mendimet e tyre të vlerësohen;
- Aftësitë e shkëlqyeshme të komunikimit me të rriturit dhe fëmijët;
- Aftësia për të qëndruar i qetë kur lindin shqetësime, veçanërisht kur një fëmijë ka nevojë për mbrojtje;
- Aftësitë për të punuar në bashkëpunim me të tjerët, për të siguruar zbatimin e politikës dhe për të reaguar kur ndodhin incidente;
- Angazhimi për mbrojtjen e fëmijëve dhe respekti për të drejtat e tyre, së bashku me aftësitë avokuese;
- Aftësitë për të zhvilluar sesione trajnime dhe prezantime;
- Aftësitë për të mbajtur konfidencialitetin e informacionit.

Emri dhe detajet e kontaktit të personit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve duhet të afishohen qartë në zyrën e organizatës, dhe stafi i ri duhet të informohet për rolin e tij. Zbulimi i informacionit personal për fëmijët, përfshirë rastet, duhet të kufizohet vetëm te ata punonjës që kanë nevojë të dinë për rastin. Bordi i KEC, si organi më i lartë qeverisës i organizatës, do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për mbikëqyrjen e punës së personit përgjegjës dhe sigurimin e zbatimit të politikës.

3.5. Kodi i sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve

KEC angazhohet për të mbrojtur fëmijët nga çdo formë abuzimi dhe shfrytëzimi. Organizata do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe/ose reaguuar ndaj situatave të tilla që përfshijnë fëmijët. KEC do të përgjigjet ndaj çdo raporti për abuzim, qoftë të vërtetë apo të dyshuar, në përputhje me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës, pa marrë parasysh natyrën e raportit, akuzës apo raportuesit.

Kodi i sjelljes i KEC përmban udhëzime për standardet etike dhe sjelljen e përshtatshme të të rriturve ndaj fëmijëve dhe është hartuar me qëllim të mbrojtjes së interesave më të mira të fëmijëve. KEC synon që të gjithë, fëmijët dhe të rriturit, të angazhohen në një mjedis të sigurt dhe të këndshëm gjatë pjesëmarrjes në aktivitetet dhe programet e saj. Në këtë kontekst, janë të domosdoshme udhëzimet e mëposhtme për veprimet që duhen bërë apo jo:

Ne gjithmonë duhet të:

- Jemi të vetëdijshëm se çfarë përbën abuzimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve (përfshirë në Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës) dhe të kuptojmë dispozitat e saj;
- Njohim shenjat e abuzimit dhe të raportojmë çdo vëzhgim të dyshimtë menjëherë te personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve;
- Sigurohemi që të dimë kush është personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në organizatë;
- Respektojmë hierarkinë dhe procedurat e raportimit;
- Trajtojmë të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë: të jemi gjithëpërfshirës dhe të përfshijmë të gjithë fëmijët pa diskriminim;
- Jemi të kujdesshëm për mënyrën se si gjuha, veprimet dhe marrëdhëniet tona me fëmijët mund të perceptohen;
- Sigurojmë një mjedis mundësues për zhvillimin personal, fizik, social, emocional, moral dhe intelektual të fëmijëve;
- Inkurajojmë dhe respektojmë zërat dhe pikëpamjet e fëmijëve;
- Fuqizojmë fëmijët për të mbrojtur veten më mirë;
- Jemi të vetëdijshëm për situatat me rrezik të lartë midis bashkëmoshatarëve (p.sh., përzjerja e pakontrolluar e fëmijëve më të mëdhenj dhe më të vegjël dhe mundësitë e diskriminimit ndaj të miturve);
- Jemi të vetëdijshëm për mundësinë e abuzimit midis bashkëmoshatarëve (p.sh., bullizmi i fëmijëve);
- Zhvillojmë masa të veçanta/mbikëqyrje për të mbrojtur fëmijët më të vegjël dhe veçanërisht të cenueshëm nga abuzimi i bashkëmoshatarëve dhe i të rriturve;
- Respektojmë të drejtat bazë të të tjerëve duke u përballur me drejtësi, ndershmëri dhe takt, dhe duke trajtuar njerëzit me dinjitet dhe respekt;
- Punojmë aktivisht për të siguruar nivelet më të larta të respektit ndaj njëri-tjetrit;
- Mbajmë standarde të larta të sjelljes personale dhe profesionale, si për veten ashtu edhe për të tjerët;
- Mbrojmë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve, vetes dhe të tjerëve;
- Kufizojmë qasjen e fëmijëve ndaj ndonjë materiali elektronik të papërshtatshëm dhe/ose nuk i ekspozojmë fëmijët ndaj këtyre materialeve;
- Respektojmë në çdo kohë konfidencialitetin e informacionit personal të fëmijëve;
- Marrim pëlqimin me shkrim nga fëmija dhe prindi/kujdestari kur fotografojmë, filmojmë ose kërkojmë informacion personal për aktivitete (shih seksionin 7);
- Sigurojmë që të paktën dy anëtarë të stafit të jenë të pranishëm në takimet me fëmijët (për të lejuar dikë të merret me nevojat e menjëhershme të fëmijëve);
- Sigurojmë që kur përfshijmë fëmijë me aftësi të kufizuara, të gjitha ndërtesat të jenë plotësisht të qasshme për ta;
- Sigurojmë informacion të saktë për pajisjet specifike të përdorura nga fëmijët me aftësi të kufizuara para ngjarjeve për të mundësuar qasje në të gjitha ndërtesat, takimet dhe objektet;

- Sigurojmë që të rriturit shoqëruar të mos jenë më të rinj se 21 vjeç, përveç në rrethana të jashtëzakonshme dhe të rëna dakord paraprakisht;
- Kur pjesëmarrësit ftohen që të qëndrojnë gjatë natës, aranzhimi për ndarjen e dhomave duhet të bëhet me pëlqimin paraprak të prindërve/kujdestarëve dhe fëmijëve.

Ne gjithmonë duhet të shmangim:

- Përfshirjen në çdo formë të aktivitetit seksual me fëmijët;
- Shfaqjen e ndonjë veprimi ose sjellje që mund të interpretohet si praktikë e dobët ose potencialisht abuzive, p.sh., sjellje e papërshtatshme ose provokuese në mënyrë seksuale;
- Lejimin e një fëmije të qëndrojë gjatë natës në dhomën e një të rrituri ose të flejë në të njëjtën dhomë me të rriturit (përveç nëse është dhënë pëlqimi specifik paraprak nga fëmija dhe prindi/kujdestari i tij);
- Kryerjen e aktiviteteve për fëmijët që ata mund t'i bëjnë vetë, përfshirë veshjen, larjen dhe kujdesin personal;
- Diskriminimin, turpërimin, nënçmimin ose poshtërimin e fëmijës, përfshirë çdo gjë që mund të konsiderohet abuzim emocional (p.sh. përdorimi i gjuhës së papërshtatshme që do të ndikojë emocionalisht te fëmija ose tregimi i një historie/ngjarjeje që do të ketë ndikim emocional te fëmija);
- Goditjen ose sulmin fizik të fëmijëve;
- Sjelljen në një mënyrë që mund të jetë abuzive ose të rrezikojë të tjerët nga abuzimi;
- Qëndrimin vetëm me një fëmijë në vende të veçuara në çfarëdo rrethane;
- Lejimin e fëmijëve të përfshihen në lojëra seksualisht provokuese me njëri-tjetrin;
- Puthjen, përqaftimin, gudulisjen, fërkimin ose prekjen e një fëmije në mënyrë të papërshtatshme ose në mënyra të papranueshme kulturalisht (p.sh., inicimin e kontaktit fizik, si mbajtja e duarve, përveç nëse iniciohet nga fëmija);
- Sugjerimin ose inkurajimin e sjelljeve ose marrëdhënieve të papërshtatshme të çfarëdo lloji;
- Bërjen e fotografive, videove ose kërkimin e informacionit personal, përveç nëse kërkohet për aktivitetet e institucionit/organizatës;
- Keqpërdorimin e të dhënave kontaktuese të fëmijëve;
- Lejimin e shkeljes së këtij kodi nga të tjerët – stafi, praktikantët, konsulentët, etj.

Çdo person i lidhur me KEC duhet të raportojë te personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve çdo vëzhgim të dyshimtë ose abuzim të pretenduar, çdo shkelje të Kodit të Sjelljes ose Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe çdo rrethanë ose situatë që mund të jetë subjekt i keqinterpretimit.

4

Reagimi dhe Mbrojtja

4.1. Strategjia e zbatimit: Procedurat e raportimit

I gjithë stafi, menaxhmenti, vullnetarët, dhe praktikantët duhet të jenë vigjilentë për shenjat që mund të sugjerojnë se një fëmijë ka nevojë për ndihmë (shih shtojcën 1). Vendimi për të raportuar mund të jetë një përgjegjësi shumë sfiduese. Procedura e raportimit është bërë gjerësisht e disponueshme për të siguruar që të gjithë t'i kenë të qartë hapat që duhen ndërmarrë lidhur me sigurinë e fëmijëve dhe dëshmitarëve të tjerë.

Të gjitha provat, dyshimet ose shkeljet e pretenduara ose të dyshuara të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës të institucionit/organizatës do të raportohen menjëherë te personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve duke përdorur formularin e raportimit (shih shtojcën 2). Parimi udhëzues duhet të jetë që siguria e fëmijës është gjithmonë konsiderata kryesore. Këto të dhëna do të ruhen në mënyrë të sigurt me qasje të kufizuar vetëm për personin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve ose bordin.

Në takimet dhe aktivitetet ku fëmijët janë të përfshirë drejtpërdrejt, fëmijët do të informohen në një mënyrë miqësore për ta, për politikën e institucionit/organizatës, kodin e sjelljes, ekzistencën e personit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe mekanizmin e ankesave.

Hapi i parë është të përcaktohet nëse shqetësimet janë të brendshme për institucionin/organizatën ose lidhen me një situatë të jashtme.

Kur një shqetësim për mbrojtjen e fëmijës ju vihet në dukje – VEPRONI.

VEPRONI në lidhje me shqetësimin tuaj / Nëse keni dyshime, flisni hapur.

Vendoseni fëmijën në qendër. Mbrojtja e fëmijës është konsiderata kryesore.

Koha është e çmuar. Siguroni veprime të shpejta, të përshtatshme dhe konfidenciale në lidhje me mbrojtjen e fëmijës.

Nëse shqetësimi është i brendshëm - lidhur me sjelljen e stafit, menaxhmentit, vullnetarëve, praktikantëve ose anëtarëve të bordit, duhet të konsiderohet nëse do të raportohet duke zbatuar procedurat e brendshme të mbrojtjes ose të raportohet te autoritetet lokale/kombëtare. Nëse rasti lidhet me sjelljen e personit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve ose mbikëqyrësve të tij/saj, ai duhet të raportohet te autoritetet lokale/kombëtare. Në të kundërt, kur rasti lidhet me sjelljen e anëtarëve të tjerë të stafit dhe bashkëpunëtorëve, ai raportohet duke përdorur procedurat e brendshme të mbrojtjes.

Nëse shqetësimi është i jashtëm - që do të thotë se ka shqetësime për abuzim jashtë institucionit/organizatës, ai duhet të raportohet te autoritetet lokale ose kombëtare. Më pas, aplikohet e njëjta procedurë si për shqetësimet e brendshme.

Personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve do të trajtojë shqetësimet, akuzat ose pretendimet në mënyrë konfidenciale në përputhje me procesin e standardizuar të zhvilluar nga institucioni/organizata në interesin më të mirë të fëmijës, pavarësisht nga natyra e raportimit, akuzave ose kush është raportuesi ose personi i akuzuar. Personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve do të marrë veprimet e përshtatshme për të mbrojtur fëmijën/fëmijët në fjalë nga dëmtime të mëtejshme gjatë dhe pas një incidenti ose akuze. Duhet të sigurohet një vlerësim i menjëhershëm i llojit specifik të mbështetjes dhe ndihmës së nevojshme për fëmijën e prekur. Të dhënat e rëndësishme të kontaktit për shërbimet sociale, policinë dhe ndihmën emergjente duhet të jenë të disponueshme dhe lehtë të qasshme, si pjesë e këtij dokumenti. Personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve do të jetë përgjegjës për të kontaktuar familjen e fëmijës (ose kujdestarin) dhe për t'i informuar për incidentin dhe ndihmën e ofruar. Një raport (shtojca 2) duhet të përgatitet për të dokumentuar detajet e incidentit. Interesi më i mirë i fëmijës duhet të merret parasysh gjatë gjithë procesit.

4.2. Strategjia e zbatimit: Procedura e brendshme për mbrojtjen e fëmijës

Organizata/institucioni do ta pezullojë menjëherë çdo punonjës, vullnetar, praktikant, anëtar bordi, konsulent ose këshilltar që dyshohet se ka shkelur Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës, duke pritur përfundimit të hetimit.

Organizata rezervon të drejtën të marrë masa disiplinore kundër çdo individi të lartpërmendur që konstatohet se ka shkelur Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe kjo mund të rezultojë gjithashtu në raportimin e incidentit/rastit te policia.

Veprimet e natyrës penale duhet të raportohen menjëherë te policia dhe mund të rezultojnë në hetim dhe ndjekje penale.

Raporti i vlerësimit të brendshëm nga organizata do t'i dorëzohet drejtorit ekzekutiv, i cili do të marrë vendime për veprimet që do të ndërmerren. Vendimet do t'i komunikohen me shkrim individit të përfshirë në rast.

Kur shqyrtohen shqetësimet ose akuzat për shkelje të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës, procesi duhet të jetë gjithmonë i drejtë, dhe individi duhet të ketë të drejtën të apelojë vendimin. Apeli duhet të shqyrtohet nga një organ më i lartë brenda hierarkisë së organizatës.

5

Media dhe Komunikimi

Ky kapitull i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës përshkruan parimet që KEC përdor për komunikimin e jashtëm për punën e saj dhe punën e anëtarëve të saj. Kapitulli përmban parime të përgjithshme për të siguruar që fëmijët të jenë të sigurt në çdo kohë, si dhe udhëzime specifike që do të zbatohen nga stafi i KEC, si dhe fotografët, ekipet e prodhimit të filmave dhe gazetarët që mbulojnë ose vizitojnë ngjarjet dhe aktivitetet e organizatës.

Të gjitha masat për mbrojtjen e fëmijëve në Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve zbatohen në mënyrë të barabartë për aktivitetet e medias dhe komunikimit, si dhe për përdorimin e rrjeteve sociale.

Për të siguruar që të gjithë fëmijët të jenë të mbrojtur në të gjitha situatat, është e rëndësishme të kemi pëlqimin me shkrim nga prindërit/kujdestarët e fëmijëve, duke treguar qartë nëse ata japin pëlqimin për përdorimin publik të fotografive ose deklaratave të fëmijëve apo jo (shtojca 3 përfshin një formular specifik për dhënien e pëlqimit medias).

5.1. Parimet

Të drejtat dhe dinjiteti i fëmijës duhet të respektohen në çdo kohë, dhe fokusi ynë i komunikimit qëndron në respektimin e interesave më të mira të fëmijës. Ky seksion ofron udhëzime për përdorimin e imazheve, pamjeve filmike dhe tregimeve të fëmijëve për qëllime mediatike dhe komunikimi, për të siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe për të mbrojtur vetë fëmijët. Kjo, për shkak se abuzuesit ndonjëherë kanë shënjestruar imazhe të fëmijëve që kanë parë në media ose në materialet e komunikimit.

Në komunikimet e KEC lidhur me fëmijët, do të zbatohen parimet e mëposhtme:

Dinjiteti: Dinjiteti i fëmijës duhet të ruhet në çdo kohë. Gjuha e përdorur nuk duhet të poshtërojë, viktimizojë ose turpërojë fëmijën. Në imazhe, fëmijët duhet të jenë gjithmonë të veshur në mënyrë të përshtatshme dhe nuk duhet të përshkruhen kurrë në ndonjë mënyrë që mund të interpretohet si seksualisht provokuese. Mos bëni dhe mos publikoni foto të fëmijëve që janë plotësisht të zhveshur ose të veshur në mënyrë të papërshtatshme. Mos i portretizoni fëmijët si viktime (të dobët, të dëshpëruar, etj.). Imazhet duhet të paraqesin fëmijët në një mënyrë 'pozitive'.

Saktësia: Përshkrimi i fëmijëve nuk duhet të manipulohet ose të jetë i ndjeshëm në asnjë mënyrë. Imazhet dhe tregimet duhet të ofrojnë një përshkrim të balancuar të jetës dhe rrethanave të fëmijës, duke treguar përparimin që fëmijët po bëjnë. Komunikimet duhet të shmangin përgjithësimet që nuk pasqyrojnë saktësisht natyrën e situatës, dhe imazhet nuk duhet të merren dhe përdoren jashtë kontekstit

Privatësia: Çdo informatë që mund të përdoret për të identifikuar një fëmijë ose për ta vënë atë në rrezik nuk duhet të përdoret. Institucioni/organizata duhet të sigurojë që:

- Përdoren vetëm emrat e fëmijës (pa mbiemër): sigurohuni që të mos zbulohen detaje për vendin ku jetojnë, shkollën e tyre dhe informata tjera që do të çonin në vendbanimin e tyre. Nëse është e nevojshme të mbrohet identiteti i fëmijës, të dy emrat dhe imazhet duhet të ndryshohen/mbulohen;
- Informacioni për fëmijën dhe fotot e fëmijës (përfshirë informacionin e ruajtur në kompjuterë) do të mbahen në dosje të sigurta. Qasja në dosje duhet të kufizohet vetëm në ata që kanë nevojë t'i përdorin gjatë punës së tyre;
- Imazhet e regjistruara duhet të fokusohen në aktivitet dhe, kur është e mundur, të tregojnë grupe fëmijësh në vend të vetëm një fëmije;
- KEC është e përkushtuar të përfaqësojë në publikimet e saj (videot) një gamë të gjerë fëmijësh - djem dhe vajza, të moshave, aftësive dhe grupeve etnike të ndryshme. Organizata do të sigurojë diversitetin e fëmijëve që shfaqen në materialet e saj të komunikimit.

Procedura e ankesave: Çdo ankesë ose shqetësim lidhur me imazhe të papërshtatshme duhet të raportohet dhe regjistrohet ashtu si çdo shqetësim tjetër lidhur me mbrojtjen e fëmijëve (shih kapitullin 4).

5.2. Pëlqimi paraprak

Pëlqimi paraprak duhet të merret gjithmonë përpara se të bëhen fotografi, video ose të kërkohet informacion personal për fëmijët që mund të përdoren në materialet e organizatës. Pëlqimi paraprak nënkupton që fëmijët janë informuar se si organizata mund të përdorë informacionin ose imazhin/video dhe që ata nuk janë të detyruar të pranojnë përdorimin e tij. Ata gjithashtu duhet të sigurohen që vendndodhja dhe informacioni tjetër personal i tyre do të ndryshohet. Ata do të duhet të pyeten nëse dëshirojnë të japin pëlqimin për përdorimin e emrit të tyre me informacionin ose imazhin/video.

Pëlqimi duhet të merret duke plotësuar dhe nënshkruar formularin e pëlqimit për media (përfshirë në formularët e pëlqimit për media në shtojcën 4).

Pëlqimi kërkohet gjithashtu nga prindi ose kujdestari ligjor i fëmijës, i cili duhet të nënshkruajë formularin; nëse kjo nuk është e mundur, ai duhet të kërkohet nga organizata që punon me fëmijët. Organizatat që punojnë me fëmijët duhet të udhëheqin procesin e kërkimit të pëlqimit nga fëmijët dhe prindërit, pasi ata mund të ndihen më rehat të japin pëlqimin kur kërkohet nga dikush që tashmë e njohin dhe i besojnë.

Formularët e pëlqimit për media dhe formularët e tjerë të pëlqimit do të mbahen nga organizata në dosjen e fëmijës.

Marrja e pëlqimit paraprak me shkrim nuk do të thotë se nuk ka nevojë për të marrë pëlqim verbal në kohën e bërjes së fotografive/videove/intervistave.

5.3. Intervistimi i fëmijëve

Intervistimi i fëmijëve kërkon aftësi dhe respektimin e disa parimeve themelore për të siguruar që dinjteti dhe të drejtat e fëmijëve të respektohen.

Pëlqimi paraprak: Për intervistat, pëlqimi paraprak përfshin shpjegimin e temave që mund të diskutohen në intervistë dhe sqarimin e të drejtës së fëmijës për të tërhequr pëlqimin në çdo kohë. Intervistuesi duhet të vlerësojë të kuptuarit e fëmijës për pëlqimin në fillim të intervistës..

Ofrimi i mbështetjes: Gjatë intervistës, dikush i njohur për fëmijën duhet të jetë i pranishëm. Fëmijës duhet t'i jepet mundësia të zgjedhë kush do ta mbështesë gjatë intervistës.

Respektimi i të drejtës për të thënë jo: Para fillimit të intervistës, duhet bërë e qartë që fëmija duhet të flasë vetëm nëse ndihet rehat, duke i shpjeguar fëmijës që mund të ndalojë dhe të tërheqë pëlqimin në çdo kohë.

Ndjeshmëria gjinore: Merrni parasysh nevojat e ndryshme të djemve dhe vajzave dhe nëse ata do të ndiheshin më rehat të flisnin me një burrë apo grua. Gjinia duhet të merret parasysh kur vendoset se cilat tema mund të diskutohen.

Respektimi i të drejtës për të qenë i informuar: Nëse do të mbani shënime ose do të regjistroni intervistën në ndonjë mënyrë, duhet ta shpjegoni këtë për fëmijën dhe të kërkoni lejen e tij/saj për ta bërë këtë.

5.4. Vizitat nga fotografët, ekipet filmike, gazetarët dhe të tjerët

Kujdes i veçantë duhet të tregohet kur organizohen vizita për fotografë të jashtëm, ekipe filmike, gazetarë ose vizitorë në kuadër të projekteve, aktiviteteve dhe publikimeve të organizatës:

- Gazetarët, fotografët/ekipet filmike duhet të informohen plotësisht për Politikën e organizatës për Mbrojtjen e Fëmijës përpara se të takohen me fëmijët që do të intervistohen, fotografohen ose filmohen. Ata duhet të nënshkruajnë angazhimin e tyre për të respektuar këtë politikë;
- Sigurohuni që fotografët dhe prodhuesit e filmave të mos lejohen të kalojnë kohë ose të kenë qasje të pambikëqyrrur te fëmijët. Ata duhet të shoqërohen nga stafi i organizatës në çdo kohë;
- Fëmijët, prindërit dhe kujdestarët duhet të informohen se si do të përdoren filmimet, fotografitë ose tregimet dhe duhet të merret pëlqimi për këtë. Kjo ndryshon nga pëlqimi që ata kanë dhënë për përdorimin e materialeve nga organizata;
- Kopjet e imazheve, pamjeve filmike dhe tregimeve duhet t'u jepen prindërve, kujdestarëve dhe fëmijëve;
- Për të mbrojtur konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijëve, organizata duhet të informohet se si fotografët, gazetarët ose ekipet filmike synojnë të përdorin imazhet ose tregimet e fëmijëve;
- Organizata rezervon të drejtën të refuzojë lejen për përdorimin e fotografive, historive, pamjeve filmike nëse përcakton se kjo nuk do të jetë në përputhje me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës dhe parimet e organizatës për median dhe komunikimin;
- Nëse një imazh ose material nga organizata kërkohet të përdoret nga një organizatë tjetër, duhet të merret leje për përdorimin e tij, duke shënuar të drejtën e autorit © të organizatës në mbishkrim, si dhe emrin e fotografit me një titull të përshtatshëm.

6

Llogaridhënia

6.1. Monitorimi dhe Vlerësimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës është të nxirren mësimet nga përvojat praktike të rasteve, të cilat do të kontribuojnë në rishikimin dhe ndryshimin e kësaj politike.

Organizata do të monitorojë rregullisht zbatimin e procedurave dhe zbatueshmërinë e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës. Progresi, performanca dhe mësimet e nxjerra do të raportohen çdo vit nga personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve te drejtori ekzekutiv (siç përcaktohet në organizatë) dhe do të përfshihen në raportet vjetore të organizatës. Monitorimi dhe vlerësimi do të bëhen duke verifikuar nëse standardet e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës po zbatohen dhe nëse masat mbrojtëse janë funksionale. Kjo do të realizohet përmes një pyetësori me stafin, praktikantët dhe vullnetarët e organizatës për të kuptuar deri në ç'masë po përmbushen standardet e politikës, sa efektive janë ato dhe cilat përmirësime nevojiten.

Përveç monitorimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës, do të realizohet edhe monitorim reaktiv pas incidenteve, i cili do të ndihmojë në procesin e të mësuarit për organizatën dhe nëse janë të nevojshme ndryshime në politikë apo në procedurat e raportimit.

Çdo tre vjet, duhet të realizohet një rishikim i brendshëm i politikës dhe rezultatet e tij do të miratohen nga drejtori ekzekutiv. Për më tepër, rekomandohet që një vlerësues i jashtëm të shqyrtojë politikën dhe praktikën. Kjo mund të bëhet përmes certifikimit me “Keeping Children Safe”. Organizata duhet të synojë marrjen e këtij certifikimi.

6.2. Deklaratë e Angazhimit ndaj Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës

Unë, _____, kam lexuar dhe kuptuar standardet dhe udhëzimet e përshkruara në këtë Politikë për Mbrojtjen e Fëmijës. Unë pajtohem me parimet, përmbajtjen dhe njoh rëndësinë e zbatimit dhe promovimit të standardeve, procedurave dhe praktikave të mbrojtjes së fëmijëve të përfshira në këtë dokument gjatë punës/angazhimit tim në organizatë.

Gjithashtu, kuptoj se përputhshmëria me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës të organizatës do të përfshijë: kryerjen e një verifikimi të së kaluarës penale që lidhet me punën me fëmijë; deklarimin e çdo hetimi ose akuze të mëparshme ndaj meje në lidhje me çështje të mbrojtjes së fëmijëve; dhe ofrimin e dy referencave për karakterin.

Emri: _____

Pozita: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

6.3. Referenca për karakterin

Ju lutemi jepni emrin, adresën dhe të dhënat e kontaktit për dy referenca karakteri që i njihni për jo më pak se 2 vjet, duke përjashtuar anëtarët e familjes:

EMRI:	EMRI:
ADRESA:	ADRESA:
NUMRI KONTAKTUES:	NUMRI KONTAKTUES:
E-MAIL:	E-MAIL:

Shtojca

Shtojca 1: Identifikimi i Shenjave të Abuzimit

Njohja e treguesve të mundshëm të abuzimit është një proces kompleks dhe nuk ka ndonjë listë të thjeshtë kontrolli që lejon njohjen e lehtë. Ka shenja paralajmëruese të mundshme për të cilat mund të jeni vigjilentë, por ato duhet të vlerësohen me kujdes. Nuk duhet të supozohet automatikisht se po ndodh abuzim. Megjithatë, është po aq e rëndësishme të mos injoroni shqetësimet tuaja ose të neglizhoni çdo shenjë të abuzimit – këto duhet të diskutohen me personin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve sa më shpejt të jetë e mundur për të ndihmuar në vendimmarrjen për veprimin më të përshtatshëm.

Shenja të mundshme të abuzimit fizik:

- Mavijosje, djegie, ndrydhje, zhvendosje, kafshime, prerje;
- Arsyetime të pamundshme për të shpjeguar lëndimet;
- Refuzim për të diskutuar rreth lëndimeve;
- Tërheqje nga kontakti fizik;
- Mbajtja e krahëve dhe këmbëve të mbuluara edhe në mot të nxehtë;
- Mospasja e dëshirës për të marrë pjesë në aktivitete fizike që mund të përfshijnë zhveshje, p.sh. sporte;
- Frikë nga kthimi në shtëpi ose nga kontakti me prindërit;
- Shfaqje e dyshimit ose mosbesimit ndaj të rriturve;
- Tendencia vetëshkatërruese;
- Sjellje agresive ndaj të tjerëve;
- Të qenit shumë pasiv dhe pranues;
- Arratisje të vazhdueshme nga shtëpia.

Shenja të mundshme të abuzimit emocional:

- Zhvillimi fizik, kognitiv ose emocional i vonuar;
- Ankth i lartë;
- Vonesa në të folur ose shfaqje e papritur e çrregullimeve në të folur;
- Frikë nga situata të reja;
- Vetëvlerësim i ulët;
- Reagime emocionale të papërshtatshme ndaj situatave;
- Pasivitet ekstrem ose agresivitet;
- Abuzim me drogë apo alkool;
- Arratisje të vazhdueshme nga shtëpia;
- Vjedhje nga mania.

Shenja të mundshme të lënies pas dore:

- Uri e shpeshtë;
- Marrje mbetjesh ushqimi nga koshat ose pjatat, ose vjedhje ushqimi;
- Higjienë personale e dobët;
- Lodhje e vazhdueshme;
- Veshje të papërshtatshme, p.sh. rroba vere në dimër;
- Vonesa e shpeshtë ose mungesë e vazhdueshme në shkollë;
- Probleme mjekësore të patrajtuara;
- Vetëvlerësim i ulët;
- Marrëdhënie të dobëta shoqërore;
- Vjedhje nga mania;
- Abuzim me drogë apo alkool.

Shenja të mundshme të abuzimit seksual:

- Sjellje të seksualizuara që nuk përkojnë me moshën ose përdorim i gjuhës shumë të seksualizuar;
- Lagje ose ndotje e shtratit;
- Dhimbje në zonën anale ose gjenitale;
- Probleme me gjumin;
- Frikë për të qëndruar me të rriturit;
- Sjellje e shthurur (seksuale) e hershme;
- Marrje e rreziqeve ekstreme në adoleshencë.

Shenja të mundshme shqetësimi në lidhje me sjelljen e një të rrituri:

- Një person në praninë e të cilit sjellja e një fëmije ndryshon ndjeshëm, si p.sh. bëhet i tërhequr, i frikësuar, i shqetësuar ose i acaruar;
- Kërkimi ndaj një fëmije për të gënjyer ose për të mbajtur sekrete;
- Shkelje e kodit të sjelljes/protokolleve të sjelljes të organizatës;
- Inicimi i kontaktit privat me një fëmijë, qoftë personalisht, me email apo telefon.

Shtojca 2: Formulari i Raportimit për Mbrojtjen e Fëmijëve

Nëse keni dijeni se një fëmijë mund të jetë në rrezik për t'u dëmtuar, ju lutemi plotësoni këtë formular sipas dijenisë suaj më të mirë. Ju lutemi vini re se shqetësimet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të raportohen (gojarisht ose me shkrim) direkt te personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në KEC (preferohet brenda të njëjtës ditë pune). Në varësi të urgjencës, mund të vendosni ta plotësoni këtë formular para se të kontaktoni personin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, ose mund ta plotësoni raportin më pas.

Ky formular përdoret gjithashtu për të raportuar një aksident ose incident. Një aksident është një ngjarje e pa planifikuar që rezulton me lëndim ose mund të kishte rezultuar me lëndim, ose që shkakton dëme në pajisje/pronë apo dëmton mjedisin. Një incident është një ngjarje e pakëndshme ose e pazakontë.

Raporti duhet të shkruhet dhe nënshkruhet vetëm nga ju për të garantuar konfidencialitetin. Ai duhet të dërgohet vetëm te personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, i cili do ta ruajë në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, duke e trajtuar me përkushtimin më të madh për ruajtjen e privatësisë.

1. Për ju

Emri: _____

Pozita: _____

Natyra juaj e kontaktit me fëmijën: _____

Tel: _____

E-mail: _____

2. Për fëmijën

Emri i fëmijës: _____

Gjinia e fëmijës: _____

Mosha e fëmijës: _____

Adresa e fëmijës: _____

Prindërit/kujdestarët e fëmijës: _____

A i është ofruar ndonjë trajtim fëmijës?

PO ☐ JO ☐

Nëse PO, shpjegoni: _____

Trajtimi është dhënë nga: _____

A është dërguar në spital? PO ☐ JO ☐

Nëse PO, në cilin spital dhe si është dërguar: _____

3. Rreth shqetësimit tuaj; Detajet e aksidentit/incidentit

Aksidenti/incidenti është:

☐

Vërejtur nga ju

☐

Dyshuar

☐

Treguar nga dikush tjetër

Nëse shqetësimi është raportuar nga dikush tjetër, ju lutemi tregoni kush dhe natyrën e lidhjes së tyre me fëmijën:

Çfarë ka ndodhur? Jepni shkakun (si dhe pse) nëse dihet – Nëse përfshini vëzhgime personale, ju lutemi bëni dallimin mes asaj që është fakt dhe asaj që është opinion ose dëshmi e të tjerëve (p.sh. gjendja emocionale e fëmijës, lëndimet e dukshme, etj.):

A ju tha fëmija/adoleshenti ose një burim tjetër diçka juve [nëse është e rëndësishme] dhe si ju përgjigjët ju atij ose asaj: [Mos e udhëzoni fëmijën. Regjistroni detajet e vërteta.]

Data e aksidentit/incidentit të dyshuar: _____

Koha e aksidentit/incidentit të dyshuar: _____

Vendndodhja e aksidentit/incidentit të dyshuar: _____

Emri i personit të dyshuar për kryerjen e aktit (nëse është e aplikueshme): _____

A ishin të përfshirë fëmijë/njerëz të tjerë në incidentin e dyshuar? A janë fëmijë të tjerë në rrezik për t'u dëmtuar?

PËR T'U PLOTËSUAR NGA PERSONI PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE:

AKSIDENTI/INCIDENTI U HETUA:

PO

☐

JO

☐

RAPORTI I HETIMI ME SHKRIM ËSHTË I NEVOJSHËM:

PO

☐

JO

☐

NËNSHKRIMI: _____

DATA: _____

Për të përcaktuar shkakun e incidentit ose aksidentit, mund të jetë e përshtatshme të intervistohen palët që ishin të përfshira. Detajet e dëshmitarëve, deklaratat, etj. mund të shtohen këtu.

Shtojca 3. Formularët e Pëlqimit

INFORMATA PERSONALE

Emri dhe mosha:

Adresa:

Numri i telefonit:

E-mail:

A jeni i/e kënaqur të merrni pjesë në _____ (e.g. takim/ngjarje/etj)?

Ju lutemi shënoni Po ose Jo:

PO

☐

JO

☐

DËSHIROJMË TË SIGUROHEMI QË TË NDIHENI TË MIRËPRITUR DHE KOMOD PËR TË MARRË PJESË.

A keni ndonjë alergji që duhet të dimë?

PO

☐

JO

☐

Nëse po, jepni detaje:

A keni ndonjë nevoja shtesë për mbështetje që dëshironi t'i dimë (çështje të aftësisë fizike ose të të mësuarit, probleme shëndetësore mendore, vetëbesim të ulët, vështirësi në komunikim, gjëra për të cilat e keni vështirë të flisni)?

PO

☐

JO

☐

Nëse po, jepni detaje:

A ka ndonjë gjë tjetër që mund të bëjmë për t'u siguruar që mund të vini dhe të merrni pjesë plotësisht?

PO

☐

JO

☐

Nëse po, jepni detajet:

A po merrni ndonjë ilaç që duhet të dimë?

PO

☐

JO

☐

Nëse po, jepni detajet:

A keni ndonjë kërkesë dietale?

PO

☐

JO

☐

Nëse po, jepni detajet:

Nëse praktikoni ndonjë religjion, ju lutemi na tregoni nëse ka diçka që duhet të dimë lidhur me pjesëmarrjen tuaj në ngjarje?

Nëse po, jepni detajet:

INFORMATA NË RASTE TË EMERGJENCAVE

Personat për kontakt në rast EMERGJENCE. Është shumë e rëndësishme që të plotësoni këtë seksion plotësisht.

Emri 1:

Emri 2:

Lidhja me ju:

Lidhja me ju:

Numri i telefonit:

Numri i telefonit:

Në rast emergjence, pajtoheni që mund të merrni trajtim spitalor ose dentar, përfshirë anestezinë?

PO

☐

JO

☐

Detaje:

Pëlqimi im:

Pëlqimi i Prindit/Kujdestarit Ligjor (nëse është nën 18 vjeç)

Nënshkrimi:

Ky fëmijë/adoleshent nën 18 vjeç:

Vendi (ku jetoni):

Lejohet të marrë pjesë në.....(ngjarje).

Data e sotme:

Lejohet të marrë pjesë në aktivitete mediatike gjatë.....
(ngjarjes).

Është informuar rreth qëllimeve të..... (ngjarjes), natyrës
vullnetare të pjesëmarrjes.

Është informuar se mund të refuzojë të marrë pjesë në çdo
moment pa pasoja.

Lejohet të marrë kujdes mjekësor të përshtatshëm nga një
profesionist i regjistruar nëse në çfarëdo momenti fëmija ka
nevojë për kujdes mjekësor urgjent.

Emri i plotë:

Lidhja me fëmijën/adoleshentin:

Vendi:

Data:

Shtojca 4. Formulari i Pëlqimit për Media

DËSHIROJMË QË TË NDIHENI KOMOD GJATË PJESËMARRJES NË AKTIVITETET MEDIATIKE.

KEC dhe ekipi i komunikimit janë aktivë në (aktivitetet/ngjarjet/etj.).

Ne publikojmë foto dhe/ose deklarata të pjesëmarrësve. Kështu, ne informojmë publikun dhe ata që marrin vendime rreth (ngjarja).

Nëse ju ose prindërit/kujdestarët tuaj jeni të interesuar të ndiqni mediat sociale, mund ta bëni këtë duke ndjekur faqen tonë në Facebook dhe faqen e internetit.

A është në rregull për ju të merrni pjesë në dokumentimin vizual gjatë organizimit të ... (ngjarjes)?

Nëse thoni se është në rregull, mund të ndajmë foto, filma, audio, shkrime në faqen tonë të internetit ose mediat sociale; në raportet tona ose broshura; gjatë ngjarjeve tona; dhe/ose në punën që bëjmë për të promovuar të drejtat e fëmijëve dhe mbështetur fëmijët.

Ju lutemi shënoni Po ose Jo:

PO

☐

JO

☐

A është në rregull për ne të kapim zërin tuaj në film, foto, audio, shkrime dhe/ose art dhe të ndajmë këtë përmbajtje në mënyrat e përmendura më lart:

Ju lutemi shënoni Po ose Jo:

PO

☐

JO

☐

A është në rregull nëse i themi njerëzve emrin tuaj të parë kur të ndajmë këtë përmbajtje? (Për ju është ende e mundur të merrni pjesë në (ngjarja) edhe nëse nuk dëshironi që t'ua themi njerëzve emrin tuaj).

Ju lutemi shënoni Po ose Jo:

PO

☐

JO

☐

IA është në rregull për ju të flisni me mediat gjatë(ngjarja) (përfshirë foto, mbulimin nga televizioni/video/kamera)? Të gjitha intervistat me media do të kryhen në konsultim dhe në praninë e të rriturit që ju shoqëron dhe/ose një anëtar të stafit të Organizatës. Keni të drejtë të mos përgjigjeni në pyetje që nuk dëshironi të përgjigjeni.

Ju lutemi shënoni Po ose Jo:

PO

☐

JO

☐

